



**ME EMRIN E ALL-LLAHUT, MËSHIRUESIT, MËSHIRËBËRËSIT!**

Shtylla e fesë pa të cilën ajo nuk mund të mbahet është namazi. Muslimanët duhet ta kryejnë këtë ibadet para të gjitha llojeve të ibadeteve tjera. Omer ibn El-Hattabi ka thënë: “Për mua vepra më e rëndësishme e juaja është namazi. Kush e ruan atë, e ruan fenë e vet, e kush nuk e ruan, atëherë të gjitha punët i ka të pambrojtura (i janë shkatërruar)”.

Namazi është forma e parë e ibadetit që u është urdhëruar njerëzve, e numri i pesë kohëve të namazit është po ai numër të cilin Allahu i Madhërishëm ia ka caktuar Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në natën e Mi'raxhit. Nga ana tjetër, namazi ka qenë porosia e fundit e Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] para se të shpërngulet në ahiret: “*Namazin, namazin! Edhe ata që i keni nën kujdesin tuaj*”. Namazi është puna e parë për të cilën njeriu do të jep llogari (në Ditën e Gjykimit) dhe ai është ibadeti të cilin nëse e len njeriu, e humb fenë e vet. Kur të lihet namazi, atëherë te njeriu nuk mbetet asgjë nga Islami, sepse namazi është shtylla e Islamit. Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“*Puna më e rëndësishme dhe shtylla e Islamit është namazi, ndërsa kulmi i tij është lufta në rrugë të Allahut*”.

Allahu i Madhërishëm thotë:

“*E pas tyre (të mirëve) erdhën pasardhës të këqij, që e lanë namazin e u dhanë pas kënaqësive (trupore), e më vonë do të hidhen në çdo të keqe (ose në Gaja)*.” (Merjem: 59)

Abdullah ibn Mes'udi thotë: “Lënia e namazit

është mosfalja në kohë të vet, e nëse ata e kanë lënë, atëherë janë kafirë”.

“*Vazhdoni rregullisht namazin (faljet), e edhe atë namazin e mesëm...*” (El-Bekare: 238)

Përqëndrimi në namaz është falja e tij në kohën e vet, ashtu siç ka thënë Allahu i Madhërishëm: “*Pra shkatërrim është për ata që falen, të cilët ndaj namazit janë të tyre janë të pakujdesëm.*” (El-Maun: 4-5)

Këta janë ata që përherë e shtyjnë faljen e namazit në kohën e vet.

Muslimanët janë të urdhëruar që ta falin namazin brenda mundësive të tyre, sepse Allahu i Madhërishëm thotë:

“*Andaj, sa të keni mundësi ruajuni prej dënimit të Allahut...*” (Et-Tegabun: 16)

Besimtari e ka për obligim që kur të hyjë në namaz të jetë i pastër, që leximin e Kur'anit në namaz ta bëjë me përlësi dhe drejtë, si dhe t'i jenë të plota rukuja dhe sexhdeja. Nëse nuk ka mundësi të merr abdest për shkak të sëmundjes ose për ndonjë shkak tjetër, atëherë do të marrë tejumum, gjegjësisht me dhë do ta fërkojë fytyrën dhe duart e veta dhe do ta falë në kohë pa e shtyrë kohën e namazit. Po ashtu, nëse është i burgosur ose i lidhur, atëherë do ta falë namazin në atë gjendje që është, e nëse është para armikut (dhe frikohet prej sulmit në atë kohë), atëherë do ta falë namazin në atë mënyrë që e ka sqaruar Allahu i Madhërishëm:

“*Kur të jeni në udhëtim e sipër, nuk është mëkat për ju të shkurtoni namazin, nëse frikoheni se jobesimtarët do të ju sjellin ndonjë të keqe. Jobesimtarët janë armiq tuaj të hapët. Kur të jesh ti (Muhammed) bashkë me ta dhe ju falë namazin, një grup prej tyre, duke i bartur armët, le të vijë e le të falet me ty (grupi tjetër në roje), e kur të bien në sexhde (të kryejnë një rekat), këta le të qëndrojnë mbrapa jush (në roje) e le të vijë grupi tjetër, që nuk është falur, e të falet me ty dhe le t'i bartin armët dhe të jenë në*

*gjendje gatishmërie...*” (En-Nisa: 101-102)

“*... E kur të qetësoheni (nga lufta), atëherë falne namazin në mënyrë të rregullt, pse namazi është obligim (për kohë) i caktuar për besimtarët.*” (En-Nisa: 103)

Muslimani e ka për detyrë që t'i urdhërojë për namaz edhe gratë edhe burrat, madje edhe fëmijët. Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] thotë: “*Urdhëroni fëmijët tuaj të falin namaz posa t'i mbushin shtatë vjet, e nëse prej dhjetë vjetëve e më tej nuk e falin atëherë mëshoni (rrihni) dhe ndani nga shtrati*”.

Nëse njeriu moshërritur me qëllim e le qoftë edhe një namaz, atëherë nga ai do të kërkohet të pendohet, e nëse këtë e refuzon, atëherë mbi të do të ekzekutohet dënimi. Një pjesë e dijetarëve thonë se duhet të vritet si i dalë nga feja (murted) dhe nuk do t'i falet xhenazja e as nuk do të varroset në varrezat e muslimanëve. Pjesa tjetër e dijetarëve mendojnë se duhet të vritet, sepse është i njëjtë sikur krimineli i cili u del përpara njerëzve (i plaçkitë ata).

Namazi është shumë i rëndësishëm, meqë është shtylla e Islamit. Nga të gjitha ibadetet tjera Allahu i Madhërishëm namazin e ka përmendur në Kur'an më së shumti dhe shpeshherë e ka lidhur me ibadete tjera p.sh. zekatin dhe sabrin:

“*Faleni namazin dhe jepni zekatin...*” (El-Bekare: 43)

“*Kërkoni ndihmë (në të gjitha çështjet) me durim dhe me namaz...*” (El-Bekare: 45)

“*Thuaj: Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër). Me këtë (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) jam i urdhëruar dhe jam i pari i muslimanëve (i pari që pranoj dhe bindem)!*” (El-En'am: 162-163)

“*Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët: ata të cilët janë të përlur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit, ata të cilët i shmangen të kotës (fjalë a punë), dhe ata të cilët rregullisht e japin zekatin, dhe*

*ata të cilët e ruajnë nderin e vet (sa i përket jetës intime), me përjashtim ndaj grave të veta (me kurorë) dhe ndaj atyre (robërshave) që i kanë në pronësinë e vet, për të cilat nuk janë të qortuar, e kush kërkon përtej tyre (dëfrim nga të ndaluarat), të tillët janë ata që kanë shkelë normat e caktuara, dhe ata të cilët me kujdes i ruajnë ato që u janë besuar (sende ose fjalë), ruajnë edhe premtimin e dhënë, dhe ata të cilët i kushtojnë kujdes kohës së namazit të tyre. Të tillët janë mu ata trashëgimtarët, të cilët e trashëgojnë Firdevsin dhe aty ata janë përgjithmonë.” (El-Mu'minun: 1-11)*

E lusim Allahun e Madhërishëm që edhe neve edhe juve të na bëjë trashëgimtarë të Xhennetul-Firdevsit, ku do të jemi përgjithmonë.

Paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi ju. Falënderimi i takon vetëm Allahut të Madhërishëm dhe bekimi i Tij qoftë mbi Pejgamberin e Tij të fundit, mbi familjen dhe mbi as'habët e tij.

## NE JEMI MUSLIMANË

Nuk është e lejuar që Ummeti të përçahet për shkak të disa punëve të cilat Allahu i Madhërishëm dhe Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nuk ua kanë urdhëruar. Shembull për këtë janë fjalët e njeriut i cili thotë: “Unë jam shekili” apo “Unë jam karfendi”. Këto janë emërtime për të cilat Allahu i Madhërishëm nuk ka sjellë asnjë argument. Në Kur'an dhe në Sunnet, e edhe në veprimet e muslimanëve të mëparshëm, nuk ka transmetime (të cilat lejojnë që muslimani të krenohet me prejardhjen e tij ose me kombin e tij). Kur muslimani pyetet për këtë, ai duhet të përgjigjet: “Unë jam musliman që e pasoj Kur'anin dhe Sunnetin”.

Transmetohet se Muavi ibn Ebi Sufjani e ka pyetur Abdullah ibn Abbasin: “A e pason ti Aliun apo Othmanin?”, e ai është përgjigjur: “Nuk e pasoj as Aliun, e as Othmanin, por e pasoj Sunnetin e Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]”.

Gjeneratat e mëparshme kanë thënë se të gjitha pasimet e epsheve çojnë në zjarr, ndërsa disa kanë thënë: “Nuk e di se cila dhunti e Allahut është më e madhe, ajo çka na ka udhëzuar në Islam apo ajo që na ka ruajtur nga pasimi i verbër i këtyre epsheve”. Allahu i Madhërishëm në Kur'an na ka emërtuar si muslimanë, mu'minë dhe me robër të Tij. Ne nuk guxojmë që t'i lëmë emërtimet me të cilat na ka emërtuar Allahu i Madhërishëm, e t'i marrim llagapet të cilat njerëzit i kanë vënë për vete, për të cilat nuk gjejmë argument as në Kur'anin Fisnik e as në Sunnetin e Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Marrë nga libri: Porosia më e mirë  
Të autorit: Shejhul-Islam Ahmed ibën Tejmije  
Botuar nga Klubi Studentor

## KLUBI STUDENTOR

*Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.*

Boton:  
Shoqata Qytetare  
Klubi Studentor

e-mail: [penastudentore@hotmail.com](mailto:penastudentore@hotmail.com)



# RËNDËSIA E RUAJTJES SË NAMAZIT

